



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1599/ 9 prot.

Datë 26.06.2026

V E N D I M
Nr. 873/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtare
Kreshmik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF: 75953-02-12-2026, me objekt “*Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit*”, me fond limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “CLIMACASA” ku ka kërkuar shfuqizim të Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “ALTEC” SHPK në procedurën e prokurimit sipërpërmendur.

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “CLIMACASA” ku ka kërkuar Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit sipërpërmendur.

Lënien të skualifikuar operatorin ekonomik ofertues “SULOLLARI-KLIMA” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimimi.

Ankimues:

Operatori ekonomik “SULOLLARI-KLIMA” SHPK, me NIPT K01529003M, me adresa: Rruga Muhamet Gjollesha 71/3, Kati 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK me NIPT L07805502F dhe adresë: *Lagjja Beselidhja, Rruga Shtraus , Pallati Nr. 1, kati perdhe, Njesia me numer pronesie 5/82-N1, ZK, Lezhë*

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tirane me adresë: *Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë*

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “SULOLLARI-KLIMA” SHPK, me NIPT K01529003M, me adresa: *Rruga Muhamet Gjollesha 71/3, Kati 1, Tiranë.*

Operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, me NIPT K57923807Ë, me adresa: *Ballsh "Mallakaster", Njesia Administrative "Fratar", Fshati "Ninesh", Rruga "Qender", Godina Nr.15.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar”, me Nr. REF: 75953-02-12-2026, me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit”, me fond limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 17.03.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 12.05.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. SULOLLARI–KLIMA sh.p.k	658 640 lekë I skualifikuar
2. CLIMACASA Sh.p.k	969 342 lekë I skualifikuar
3. ALTEC shpk	2 813 920 lekë I kualifikuar

II.3.1. OE “SULOLLARI–KLIMA” shpk- i skualifikuar, u njoh me arsyet e skualifikimit: “Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M me ofertë ekonomike shumatoren e çmimeve për njësi 658 640 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, është anomalisht e ulët. Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave referuar nenit 93, të LPP

dhe nenit 82, pika 4 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i dërgoj operatorëve ekonomik ofertues, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) kërkesën për sqarim të ofertës anomalisht të ulët. Operatori ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M depozitoi argumentimin mbi ofertën anomalisht të ulët protokolluar nga ana e autoritetit kontraktor me Nr.1671 datë 23.04.2026, ku Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi analizoi dokumentacionin justifikues konstatoi se: 1. Nga tabela e argumentuar nga ana e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M dhe faturave të vendosura në dispozicion për të justifikuar materialet e blera me cmim të ulët rezultojnë një mospërputhje e çmimit të vendosur në tabelë dhe çmimit të blerjes së reflektuar në faturat tatimore. Ndër zërat që mund të përmëndim janë: Nr. Emërtimi i mallit Cmimi në tabelë Lekë pa Tvsh Cmimi në faturë Lekë pa Tvsh 1 Termostat komandimi 200 600 2 Cajruer automatik me sferë tip spirovent 1/2" 100 388,74 3 Filtër ajri 50 611 4 Kondesator 33 40 5 Rele termike 600 720/1300 6 Manometër presioni I ujit brënda në chiller 195 234,87 7 Automat 2P 32 A 680 815,8 2. Gjithashtu ka një mospërputhje midis çmimit të vendosur në faturë tatimore dhe çmimit të marrë si ofertë për artikuj të njëjtë. 3. Në argumentimin e bërë nga operatori ekonomik është cituar se avantazhi në ofertim me cmim më të ulët vjen si rezultat i eliminimit të ndërmjetësve (blerje direkt nga kompani prodhuese), ndërkohë faturat e vendosura në dispozicion janë nga subjekte rishitës të produkteve dhe jo kompani prodhimi. Gjithashtu është cituar se ka kontrata afatgjata me furnitorë prodhues por një gjë e tillë nuk është reflektuar në dokumentacionin që është vendosur në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. 4. Në argumentim deklarohet se kosto e pagës për orë pune është në vlerën 300 lekë/orë, pra: $50.000/176 = 284$ lekë/orë Ndërkohë kostoja e punëdhësit për orë punë përfshin vlerën $50.000 \times 16,7\% = 8350$ Totali kostot për punëdhënësin është $50.000 + 8350 = 58350$ lekë Kosto për orë pune për punëdhënësin është $58350/174 = 335,3$ lekë/orë. Rillogaritja e kostos për orë pune rezultojnë se shuma e fitimit potencial të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik nuk është e justifikueshme pasi rezultojnë me humbje dhe jo me fitim të pritshmëm sic deklarohet, konkretisht $335,3 - 300 = 35,3$ lekë/orë pune. 35,3 lekë/orë pune është kosto shtesë që nuk është parashikuar në përlllogaritjen e fitimit. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M me ofertë ekonomike shumatoren e çmimeve për njësi 658 640 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit dhe nuk i përmbush kushtet kumulative duke mos justifikuar ofertën anomalisht të ulët, sipas nenit 93, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.”.

II.3.2. OE “CLIMACASA” shpk- i skualifikuar, u njoh me arsyet e skualifikimit:

“Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultojnë se oferta e operatorit ekonomik “Climacasa” sh.p.k me Nipt L07805502F me ofertë ekonomike shumatoren e çmimeve për njësi 968 342 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e dyzet e dy) Lekë pa Tvsh, është anomalisht e ulët. Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave referuar nenit 93, të LPP dhe nenit 82 pika 4 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, i dërgoi operatorit ekonomik ofertues, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) kërkesën për sqarim të ofertës anomalisht të ulët, me datë 21.04.2026. Operatori ekonomik “Climacasa” sh.p.k me Nipt L07805502F, më datë 22.04.2026 ka kthyer përgjigje nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) por në përgjigjen e dhënë nuk ka paraqitur dokumentacionin justifikues për ofertën anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 të LPP dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës.”

II.4. Në datën 21.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 33, datë 25.05.2026, ku fitues rezulton operatori ekonomik ALTEC shpk.

II.5. Në datën 22.05.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/6702 dhe me nr. 1599/2026 prot, datë 22.05.2026 e operatorit ekonomik “SULOLLARI-KLIMA” shpk, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1599/1 prot., datë 25.05.2026 lidhur me arsyet e skualifikimit të OE “SULOLLARI-KLIMA shpk”, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1599/2026 prot., datë 22.05.2026.

II.5.2. OE “ALTEC shpk”, ka dërguar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike “Formular Argumentash”, të protokolluar me nr. 1599/2 prot., datë 01.06.2026, për lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik ankmiues.

II.5.3. OE “SULOLLARI-KLIMA shpk”, ka dërguar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike “Formular Argumentash”, të protokolluar me nr. 1599/3 prot., datë 04.06.2026.

II.5.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 2242/3 prot., datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1599/4 prot., datë 12.06.2026 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së OE ankmiues, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.5.5. Me shkresën nr.1599/5 prot., datë 17.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor me kërkesën me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni”, duke i kërkuar informacion për sa më poshtë: [...]autoriteti kontraktor duhet të dërgojë informacion të hollësishëm mbi hapat e ndjekura nga KVO-ja për trajtimin e ofertës anomalisht të ulët të operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga ky operator ekonomik për të justifikuar ofertën e ekonomike, e cila rezultuon anomalisht e ulët”.

II.5.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 2647/1 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1599/6 prot., datë 24.06.2026 me objekt “Kthim përgjigje”, dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni i kërkuar.

II.6. Në datën 27.05.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6729 dhe me nr. 1659/2026 prot., datë 28.05.2026 e operatorit ekonomik “CLIMACASA” SHPK, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit si edhe publikoi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “CLIMACASA” SHPK, lidhur me pretendimet e tij mbi lënien të skualifuar të operatorit ekonomik ofertues “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “CLIMACASA” SHPK, lidhur me pretendimet e tij mbi kualifikimin e operatorit ekonomik ofertues “ALTEC” SHPK.

II.6.1. Nëpërmjet shërbimit postar, nga operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK është depozituar pranë KPP_së, Formular ankese, të protokolluar me nr. 1659/2 prto., datë 28.05.2026.

II.6.2. OE “ALTEC shpk”, ka dërguar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike “Formular Argumentash”, të protokolluar me nr. 1659/3 prot., datë 01.06.2026, për lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë ankimues.

II.6.3. Më datë 01.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin me nr.737/2026:

1.Të korrigjojë Formularin për Publikim me Nr.1659/1 prot., datë 28.05.2026 të operatorit ekonomik “CLIMACASA” SHPK për ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75953-02-12-2026, me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit” me fond limit 29,981,240.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tirane, lidhur me pretendimet e tij mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, duke shtuar si më poshtë:

- Në vendimmarrjen e autoritetit kontraktor është konstatuar se operatori ekonomik “SULLOLLARI KLIMA” sh.p.k. ka ofertuar se kostoja e pagës për orë pune është 300 lekë/orë, ndërkohë që autoriteti kontraktor, pas rillogaritjes së kostos së punëdhënësit, ka arritur në përfundimin se kostoja reale minimale për orë pune është 335.3 lekë/orë. Diferenca prej 35.3 lekë/orë është vlerësuar si kosto shtesë e paparashikuar në përlllogaritjen e fitimit të deklaruar nga operatori. Ky arsyetim i autoritetit kontraktor është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

- sipas arsytimit të përgatitur, oferta e “SULLOLLARI-KLIMA” sh.p.k. bie edhe në kundërshtim me vetëdeklarimet në dokumentet standarde të tenderit, përkatësisht me deklaratat mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit dhe zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës. Nëse operatori ka deklaruar se zbaton detyrimet ligjore për pagat dhe marrëdhëniet e punës, por njëkohësisht ka ofertuar çmime orare që nuk

mbulojnë koston minimale ligjore të punëdhënësit, atëherë ekziston mospërputhje ndërmjet deklarimit formal dhe përmbajtjes reale ekonomike të ofertës.”

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

2. Të korrigjojë Formularin për Publikim me Nr.1659/1 prot., datë 28.05.2026 të operatorit ekonomik “CLIMACASA” SHPK për ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75953-02-12-2026, me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit” me fond limit 29,981,240.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tirane, lidhur me pretendimet e tij mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK, duke shtuar si më poshtë:

- 1. të verifikojnë ofertën ekonomike të operatorit ekonomik “ALTEC” sh.p.k., me NIPT K57923807Ë, veçanërisht çmimet për njësi të ofertuar për zërat “Orë pune”, “Orë pune ing. elektrik/elektronik” dhe çdo zë tjetër që lidhet me koston e punës;

2. të krahasojnë këto çmime me koston minimale ligjore të punëdhënësit për orë pune, duke përfshirë pagën minimale, sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore;

3. të zbatojnë ndaj “ALTEC” sh.p.k. të njëjtin standard vlerësimi që Autoriteti Kontraktor ka zbatuar ndaj operatorit ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” sh.p.k.;

4. nëse rezulton se çmimet e ofertuar nga “ALTEC” sh.p.k. për orët e punës janë nën koston minimale ligjore, të konstatojnë pavlefshmërinë e ofertës së tij;

5. të shfuqizojnë vendimin e kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorit ekonomik “ALTEC” sh.p.k., nëse verifikimi konfirmon mospërputhjen e ofertës me detyrimet ligjore në fushën e pagave, sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shëndetësore.

-Kërkesë për konstatimin e përgjegjësisë administrative në rastin e përdorimit të standardeve të ndryshme në vlerësimin e ofertave;”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6.4. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1659/6 prot., datë 02.06.2026 lidhur me arsyet e skualifikimit të OE “CLIMACASA shpk”, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1659/2026 prot., datë 28.05.2026, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “CLIMACASA” SHPK , lidhur me pretendimet e tij mbi Lënien të skualifuar të operatorit ekonomik ofertues “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK si dhe

pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “CLIMACASA” SHPK, lidhur me pretendimet e tij mbi kualifikimin e operatorit ekonomik ofertues “ALTEC” SHPK.

II.6.5. Nëpërmjet shkresës me nr. 2306/2 prot., datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1659/7 prot., datë 12.06.2026 me objekt “*Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik*”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së OE ankimues, ku konstatohet se e ka **pranuar** atë.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në Sistemin e ankesave elektronike nga operatorë ekonomikë të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Në datën 27.05.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6729 dhe me nr. 1659/2026 prot., datë 28.05.2026 e operatorit ekonomik “CLIMACASA” SHPK, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit si edhe publikoi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “CLIMACASA” SHPK, lidhur me pretendimet e tij mbi lënien të skualifuar të operatorit ekonomik ofertues “SULOLLARI-KLIMA” SHPK dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “CLIMACASA” SHPK, lidhur me pretendimet e tij mbi kualifikimin e operatorit ekonomik ofertues “ALTEC” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 2306/2 prot., datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1659/7 prot., datë 12.06.2026 me objekt “*Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik*”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së OE ankimues, ku konstatohet se e ka **pranuar** atë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Date, më 10.06.2026

10.06

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2306/2 prot.

Tiranë, më 10.06.2026

LËNDA: Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik

DREJTUAR:

CLIMACASA SH.P.K, NIPT L07805502F
Z.BASHKIM DELIJA, ADMINISTRATOR
*Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, Kati përdhe,
Njësia me numër pronësie 5/82 N1, ZK Nr. 8632, Lagjja Beselidhja,
Nr. 0682098979*

PËR DIJENI:

SULLOLLARI - KLIMA SH.P.K, NIPT K01529003M,
Z.ARDIAN SULLOLLARI, ADMINISTRATOR
*Rruga "Muhamet Gjollësja", 71/3, Kati 1, Tiranë"
Nr.0672037959*

ALTEC SH.P.K, NIPT K57923807W
ALEKSANDER ALIAJ, ADMINISTRATOR
*Rruga e "Durrësit" pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Pallati 240/1,
Nr. 6 Kodi postar 1057, Tiranë
Nr. 0692063153*

KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", "Pallati i Kongreseve", Kati i Parë,
Tiranë, Tel: +3554 2281851, email: kpp_info@kpp.gov.al*



Të nderuar,

Në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), dhe pas depozitimit të ankesës së operatorit ekonomik **CLIMACASA SH.P.K** me **NIPT L07805502F** në sistemin e ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik në datë 27.05.2026 protokolluar nga ana e autoritetit kontraktor me **Nr.2306 prot. date 28.05.2026**, për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur" me objekt: "**Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit**", me fondin limit **29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh**, të publikuar më datë 17.03.2026, pas shqyrtimit të ankesës së dorëzuar ju bëjmë me dije se:

Sqarimet dhe vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave:

Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, me datë 01.06.2026 me anë të shkresës me Nr.2242/1 prot. ka ngritur Urdhrin për Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Me marrjen e urdhrin, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, mori masa për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik **CLIMACASA SH.P.K** me **NIPT L07805502F**. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se autoriteti kontraktor ka bazuar analizën e tij mbi shumatorën e çmimeve për njësi, pa kryer llogaritjen e vlerës totale të ofertës në raport me fondin limit të procedurës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vlerëson se fondi limit përfaqëson vlerën maksimale të kontratës që autoriteti ka vënë në dispozicion për realizimin e objektit të prokurimit. Për rrjedhojë, krahasimi i ofertës ekonomike duhet të kryhet në raport me vlerën e fondit limit, dhe jo me shumatorën e çmimeve për njësi, e cila shërben si element vlerësimi ku kjo është parashikuar shprehimisht edhe në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Në këto kushte, interpretimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bie ndesh me parimet që rregullojnë vlerësimin e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

Nisur përse më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në mbështetje të nenit 93 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe nenit 82 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), vlerëson se edhe analiza e ofertës duhet të kryhet në raport me vlerën e fondit limit, pasi mbështetja në shumatorën e çmimeve për njësi mund të çojë në rezultate që nuk pasqyrojnë vlerën reale të ofertës ekonomike.

Nga verifikimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik rezultoi se vlera e ofertës së paraqitur nuk përmbush kushtet ligjore për tu konsideruar ofertë anomalisht e ulët dhe sipas formulës së përcaktuar nga legjislacioni i prokurimit publik, në momentin e vlerësimit, nuk bie nën pragun ligjor që do të aktivizonte procedurën e verifikimit për ofertë anomalisht të ulët.

Sa i përket pretendimeve për skualifikimin e operatorit ekonomik SULOLLARI-KLIMA SH.P.K NIPT K01529003M, nga shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, u konstatua se operatori ekonomik i sipërpërmendur, ka ofertuar me çmim për njësi për zërat "orë pune", "Orë pune ing. elektrik/elektronik me vlerë 300 lekë/orë pune dhe sipas vendimit të marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk janë përmbushur detyrimet ligjore në fushën e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, më konkretisht:

$50.000/176 = 284$ lekë/orë

Ndërkohë kostoja e punëdhësit për orë pune përfshin vlerën

$50.000 \times 16,7\% = 8350$

Totali koston për punëdhënësin është $50.000 + 8350 = 58350$ lekë

Kosto për orë pune për punëdhënësin është $58350/176 = 335,3$ lekë/orë.

Rillogaritja e koston për orë pune rezultoi se shuma e fitimit potencial të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik nuk është e justifikueshme pasi rezultoi me humbje dhe jo me fitim të pritshëm sic deklaroi, konkretisht $335,3 - 300 = 35,3$ lekë/orë pune.

$35,3$ lekë/orë pune është kosto shtesë që nuk është parashikuar në përlogaritjen e fitimit.

Nga shqyrtimi i ofertës, në mbështetje të nenit 92 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, konstatohet se oferta e operatorit ekonomik **SULOLLARI-KLIMA sh.p.k, me NIPT K01529003M** nuk ka rezultuar në përputhje me kërkesat e tenderit dhe nuk i përmbush kushtet kumulative duke mos justifikuar ofertën anomalisht të ulët, sipas nenit 93, pika 2

të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke u cilësuar si ofertë të pavlefshme.

Sa i përket pretendimeve për skualifikimin e operatorit ekonomik “ALTEC” SH.P.K me NIPT K57923807W, nga shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, u konstatua se operatori ekonomik i sipërpërmendur, ka ofertuar me çmim për njësi për zërat “Orë pune”, “Orë pune ing. elektrik/elektronik” me vlerë 306 lekë/orë pune.

Në zbatim të Vendimit Nr. 737/2026 me Nr. prot 1659/5 datë 01.06.2026, pas shqyrtimit të dokumentacionit, precedentit të mësipërm dhe standartit të ndjekur në vlerësim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “ALTEC” SH.P.K me NIPT K57923807W nuk janë përmbushur detyrimet ligjore në fushën e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

PËRFUNDIMISHT: Bazuar në shqyrtimin e elementëve të ankesës së operatorit ekonomik CLIMACASA SH.P.K me NIPT L07805502F, për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit”, me fondin limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, të publikuar më datë 17.03.2026, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pranon pretendimet e ngritura në ankesën e administruar në Sistemin e Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e tij” dhe “Skualifikimin e operatorëve ekonomik ALTEC sh.p.k me NIPT K57923807W dhe SULOLLARI-KLIMA sh.p.k me NIPT K01529003M.

Sa më sipër, referuar nenit 114 pika 3 c) të Ligjit nr.162/2020 për Prokurimin Publik dhe nenit 102 pika 1 c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendos:

Pranimin e ankesës të operatorit ekonomik CLIMACASA SH.P.K me NIPT L07805502F.

Për si më sipër vijon, në lidhje me procedurën e prokurimit publik me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit”, me fondin limit 29 981 240 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, të publikuar më datë 17.03.2026, pas shqyrtimit të ankesës do të zbatohen afatet ligjore të ankimit.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, do të mbyllë çështjen për ankesën e pranuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankmiues “CLIMACASA” shpk në lidhje me arsyet e skualifikimit të tij, dhe lidhur me pretendimet e tij mbi kualifikimin e operatorit ekonomik ofertues “ALTEC” SHPK, i cili nuk ka paraqitur Argumenta pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik si dhe Formular Ankesë duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sikurse përcaktohet në nenin 113 të LPP. Lidhur me pjesën e pranuar të ankesës së “Climasaca” për lëniën të skualifikur të OE “SULLOLLARI-KLIMA sh.p.k, Komisioni vlerëson se nuk jemi në kushtet e nenit 115 të LPP për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar, për aq kohë sa, OE “Sulollari Klima” shpk ka paraqitur Formularin e Ankesës në sistemin elektronik të ankesave (SAE), pranë Komisionin e Prokurimit Publik në përputhje me nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

III.2. Lidhur me arsyet e skualifikimit të OE ankmiues “SULLOLLARI-KLIMA shpk”, se: “.....“Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M me ofertë ekonomike shumatoren e çmimeve për njësi 658 640 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, është anomalisht e ulët. Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave referuar nenit 93, të LPP dhe nenit 82, pika 4 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i dërgoj operatorëve ekonomik ofertues, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) kërkesën për sqarim të ofertës anomalisht të ulët. Operatori ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M depozitoi argumentimin mbi ofertën anomalisht të ulët protokolluar nga ana e autoritetit kontraktor me Nr.1671 datë

23.04.2026, ku Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi analizoi dokumentacionin justifikues konstatoi se: 1. Nga tabela e argumentuar nga ana e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M dhe faturave të vendosura në dispozicion për të justifikuar materialet e blera me cmim të ulët rezultojnë një mospërputhje e çmimit të vendosur në tabelë dhe çmimit të blerjes së reflektuar në faturat tatimore. Ndër zërat që mund të përmëndim janë: Nr. Emërtimi i mallit Çmimi në tabelë Lekë pa Tvsh Çmimi në faturë Lekë pa Tvsh 1 Termostat komandimi 200 600 2 Çajruer automatik me sferë tip spirovent 1/2" 100 388,74 3 Filtër ajri 50 611 4 Kondesator 33 40 5 Rele termike 600 720/1300 6 Manometër presioni I ujit brenda në chiller 195 234,87 7 Automat 2P 32 A 680 815,8 2. Gjithashtu ka një mospërputhje midis çmimit të vendosur në faturë tatimore dhe çmimit të marrë si ofertë për artikuj të njëjtë. 3. Në argumentimin e bërë nga operatori ekonomik është cituar se avantazhi në ofertim me cmim më të ulët vjen si rezultat i eliminimit të ndërmjetësve (blerje direkt nga kompani prodhuese), ndërkohë faturat e vendosura në dispozicion janë nga subjekte rishitës të produkteve dhe jo kompani prodhimi. Gjithashtu është cituar se ka kontrata afatgjata me furnitorë prodhues por një gjë e tillë nuk është reflektuar në dokumentacionin që është vendosur në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. 4. Në argumentim deklarohet se kosto e pagës për orë pune është në vlerën 300 lekë/orë, pra: $50.000/176 = 284$ lekë/orë Ndërkohë kostoja e punëdhësit për orë punë përfshin vlerën $50.000 \times 16,7\% = 8350$ Totali kostot për punëdhënësin është $50.000 + 8350 = 58350$ lekë Kosto për orë pune për punëdhënësin është $58350/174 = 335,3$ lekë/orë. Rillogaritja e koston për orë pune rezultojnë se shuma e fitimit potencial të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik nuk është e justifikueshme pasi rezultojnë me humbje dhe jo me fitim të pritshmëm sic deklarohet, konkretisht $335,3 - 300 = 35,3$ lekë/orë pune. 35,3 lekë/orë pune është kosto shtesë që nuk është parashikuar në përlogaritjen e fitimit. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” sh.p.k me NIPT K01529003M me ofertë ekonomike shumatoren e çmimeve për njësi 658 640 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) Lekë pa Tvsh, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit dhe nuk i përmbush kushtet kumulative duke mos justifikuar ofertën anomalisht të ulët, sipas nenit 93, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke e cilësuar si ofertë të pavlefshme.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën përcjellëse me nr. 2242/3 prot., datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1599/4 prot., datë 12.06.2026 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së OE ankimues, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezultojnë, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e OE ankimues “SULLOLLARI-KLIMA shpk”, është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO më datë 16.04.2026, nëpërmjet SPE, i është drejtuar OE ankimues me kërkesë që brenda 3 ditëve pune, të paraqesë pranë autoritetit shpjegime, në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, të cilat duhet t’i argumentonte dhe dokumentonte edhe me prova shpresore.

III.2.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën përcjellëse me nr. 2242/3 prot., datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1599/4 prot., datë 12.06.2026 me objekt *“Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik”*, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së OE ankimues *“SULOLLARI-KLIMA shpk”*, me objekt *“Vendim”*, (Vendimi i KSHA nr. 69/13 datë 02.02.2026), si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 16.04.2026, që brenda 3 ditëve pune të paraqesë pranë autoritetit shpjegime, në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, të cilat duhet t'i argumentonte dhe dokumentonte edhe me prova shkresore, OE ankimues *“SULOLLARI-KLIMA shpk”*, ka dorëzuar pranë autoriteti kontraktor, me nr. 1671 prot., datë 23.04.2026 argumentimin, me qëllim, justifikimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.2.2.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së, rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 16.04.2026 OE ankimues *“SULOLLARI-KLIMA shpk”*, ka dorëzuar pranë autoriteti kontraktor, me nr. 1671 prot., datë 23.04.2026 me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- *Argumentim narrativ i ofertës ekonomike;*
- *Argumentim për anën ekonomike të çmimeve të ofertuara;*
- *Oferta e artikujve objekt prokurimi nga furnizuesi;*

III.2.3. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...].”

III.2.4. Në nenin 82 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”* të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në

dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPPsë, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.2.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të OE ankimues “SULOLLARI-KLIMA shpk”, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike e shumatores së cmimeve për njësi në vlerën prej 658’640 pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me

detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore.

Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: *b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.2.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE ankimes “Sulollari Klima” shpk”, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se argumentimi i dhënë nga OE ankimes, është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik lidhur me argumentimin/sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se OE ankimes “Sulollari Klima” shpk”, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë analitike përmes shkresës me datë 23.04.2026 me lëndë “*Kthim përgjigje kërkesës për justifikimin e Ofertës Anomalisht të Ulët*”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë si dhe me dokumentacion provues.

Përveç kësaj, KPP vëren, se OE ankimues në mbështetje të deklarime më sipër, me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka përcaktuar përmes një table një analizë për artikullin objekt-prokurimi, duke detajuar analizën e kostos në trajtë analitike e konkretisht duke përcaktuar: *Tabelë analitike për analizën për ofertën anomalisht të ulët (emërtimi i mallit, njësia, sasia, çmimi i ofertuar/njësi, çmimi i blerjes jashtë vendit, shpenzime të tjera direkte dhe indirekte, fitimi para taksave)*. Gjithashtu, ankimuesi ka paraqitur, ofertën nga furnizuesi, argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon të shoqëruara me dokumente provuese, siç janë përmendur në pikën III.2.2.1. të këtij vendimi.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK në mbështetje të deklarimeve më sipër, me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka përcaktuar përmes një table një analizë për të gjithë zërat e shërbimit të mirëmbajtjes dhe artikujt objekt-prokurimi, duke detajuar analizën e kostos në trajtë analitike e konkretisht duke përcaktuar: (përshkrimi i riparimit/shërbimit, njësia, sasia, çmimi i ofertuar/njësi, vlera, çmimi i blerjes pa TVSh, fitimi për njësi pa TVSh, fitimi në total TVSh, nr. faturës tatimore blerje, data e faturës tatimore blerje, oferta të ndryshme), në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP-së. Lidhur me argumentimin e zërit “orë pune” të përfshirë në preventiv, Komisioni konstaton, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues është deklaruar çmimi bruto 300 lekë/op. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se një mënyrë e tillë e paraqitjes së analizës për zërin “orë pune” është e konform përcaktimit të bërë në VKM nr. 776, datë 19.12.2025, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” cila ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2026. Referuar pikës 3 të VKM së sipërcituar, paga bazë minimale orare është 287.3 lekë. Nisur nga sa më sipër Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët, pasi elementët e kostos së përlogaritur prej tij dhe konkretisht paga orare minimale rezulton më e lartë se paga orare minimale e përcaktuar në pikën 3 të VKM nr. 776, datë 19.12.2025 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”. Komisioni gjykon, se referuar nenit 93 pika 2/ç, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet qartë, se nuk mjafton vetëm të vërtetosh kostot e elementeve të ofertës, por duhet edhe të jesh në përputhje me detyrimet që rrjedhin në fushën sociale dhe atë të punës, operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK me pagën orare të deklaruar në analizën e ofertës anomalisht të ulët, është konform me VKM nr. 776, datë 19.12.2025 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, ka arritur që të argumentojë ofertën anomalisht të ulët, duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Sulollari Klima” SHPK, është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së..

Gjithashtu, OE ankimues “Sulollari Klima shpk” ka argumentuar edhe elemente të tjera favorizuese në përmbushje të kushtit për origjinalitetin e shërbimit të ofruar, si përshkrimi i metodologjisë së operimit të mirëmbajtjes. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se ankimuesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së, duke

argumentuar në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij dhe duke analizuar në mënyrë të detajuar secilin prej tyre.

III.2.7. Komisioni gjykon, se një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e OE Ankimues, janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, origjinalitetin e shërnimeve të mirëmbajtjes, furnizimeve nga ofertuesi, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga OE Ankimues, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t'i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet sipas parashikimeve të *lex specialis* për prokurimin publik.

Sa më sipër, pretendimi i OE ankimues “Sulollari Klima shpk”, qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75953-02-12-2026, me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e

kondicionimit” me fond limit 29,981,240.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tirane.

2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SULOLLARI-KLIMA” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt - ankimi.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “CLIMACASA” SHPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SULOLLARI-KLIMA” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtare
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

